



1905

146/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. ~~7476~~/Prot.

Tiranë, më 15.11.2021

**Lënda:** Kthim përgjigjeje kërkesës suaj Nr. Prot. 146/21, të datës 3.11.2021

**Z. DORIAN MATLIJA**  
**QENDRA "RES PUBLICA"**

*Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7*

*Adresë e-mail: [qendra.respublica@gmail.com](mailto:qendra.respublica@gmail.com)*

**I nderuar Z. Matlija**

Në vijim të kërkesës suaj Nr. Prot. 146/21, të datës 3.11.2021, me objekt "*Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit*", dërguar në e-mail-in zyrtar të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, më datë 3.11.2021, sqarojmë se:

Pas njoftimit të vendimit përfundimtar nr. 417, datë 7.7.2021, të arsyetuar me shkrim nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, ushtroi të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të kreut VIII "Apelimi", të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe dispozitat e ligjit nr. 49/2012, ankimi dhe fashikulli gjyqësor me të gjitha aktet e vendimit nr. 417, datë 7.7.2021 të KPK-së, i janë dërguar zyrtarisht Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit, në datën 2.11.2021, me shkresë përcjellëse nr. 5081/10 prot., datë 2.11.2021.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 4, pika 7 të ligjit nr. 84/2016, ju informojmë se çështja e rivlerësimit të subjektit Ervin Karanxha dhe aktet mbi të cilin është realizuar vendimmarja e KPK-së, ndodhen në Kolegjin e Posaçëm të Apelitimit, i cili ka nën juridiksionin e tij çështjen dhe dosjen e subjektit për të cilin ju interesoheni.

Faleminderit dhe punë të mbarë.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Edmond Verçani**